



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 400/01-29894, dt. 29 Maj 2025

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Hamza Gjuka dhe pronën e bashkëpronarëve privat Atdhe (Sali) Kelmendi dhe Rezarta (Muhamed) Kelmendi, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 29 Maj 2025, mori këtë:

VENDIM

Nr. 21/2025

Mbi Miratimin për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Hamza Gjuka dhe pronën private të bashkëpronarëve Atdhe (Sali) Kelmendi dhe Rezarta (Muhamed) Kelmendi me qëllim: "Të Formimit të Rrugës tek Ura e Re" si dhe Rrugës tek "Maja e Zezë" si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të bashkëpronarëve me qëllim të formimit të rrugës tek ura e re si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.
- II. Parcela kadastrale nr: 5503-9 në sipërfaqe prej 422m² ZK Pejë pronë e bashkëpronarëve Atdhe (Sali) Kelmendi dhe Rezarta (Muhamed) Kelmendi do të merret për nevoja të krijimit të hapësirës së nevojshme për formimin e rrugës tek ura e re si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal, ndërsa parcela kadastrale nr.230-4 në sipërfaqe prej 585m² ZK Carravër pronë e Hamza Gjukës do të merret për nevoja të krijimit të hapësirës së nevojshme për formimin e rrugës tek "Maja e Zezë" si Interes Publik dhe në të njëjtën kohë do të jenë objekt këmbimi me parcelat kadastrale nr.5753-2 me sipërfaqe prej 550m² ZK Pejë pronë Komuna e Pejës dhe nr.3443-21 me sipërfaqe prej 215m² ZK Pejë pronë Komuna e Pejës.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Vlerësimet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti për Vlerësimin e Pronave të paluajtshme, të aprovuara me datën 21.05.2025.

-Pronat e Komunës, ngastra kadastrale nr.5753-2 në sipërfaqe prej 550m² ZK Pejë është vlerësuar me 80.00 €/m² që në total i bie 44,000.00 €, ndërsa ngastra me nr.3443-21 në sipërfaqe prej 215m² ZK Pejë është vlerësuar me 180.00 €/m² që në total i bie 38,700.00 €

-Prona private e bashkëpronarëve Atdhe (Sali) Kelmendi dhe Rezarta (Muhamed) Kelmendi me numër të ngastrës 5503-9 në sipërfaqe prej 422m² ZK Pejë është vlerësuar me 110.00 €/m² që në total i bie 46,420.00€.

- prona private e Hamza Gjukës me numër të ngastrës 230-4 në sipërfaqe prej 585m² ZK Carravër është vlerësuar me 50.00 €/m² që në total i bie 29,250.00 €.

- Andaj obligohen bashkëpronarët Atdhe (Sali) Kelmendi dhe Rezarta (Muhamed) Kelmendi si dhe pronari privat Hamza Gjuka që të paguajë diferencën në shumën prej 7,030.00 € Komunës së Pejës, bazuar në Vlerësimin e bërë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme.

- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do t'i nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike.
- VI. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:
MAPL,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ- së
Arkivës.



KRYESUESI I KUVENDIT,
Rexhep Kurtbogaj